



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 65/3 Prot.

Tiranë më, 22/01/2025

V E N D I M

Nr. 2 datë 22.01.2025

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Loreta Hanxhari	Kryesues
Bora Vrenjo	Relator
Henri Naqellari	Anëtar

në datën 22.01.2025, në orën 09:15 në ambientet e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Gazment Qemal Shehu** me funksion aktual Shef Sektori në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj.Bora Vrenjo; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar.

2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Gazment Qemal Shehu ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, sipas përcaktimeve të neneve 32 pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit Nr.12/2018, “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, të ndryshuar.

3. Bazuar në Nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar, Z. Gazment Shehu ka qenë subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë.

4. Subjekti i vlerësimit, Gazment Shehu, iu nënshtroi procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07 datë 17.01.2023 “*Për Procedurat dhe Mënyrat e Hedhjes së Shortit për Trupat e Vlerësimit dhe Subjektet e Vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar*”. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Znj. Loreta Hanxhari (Kryesues); Znj.Bora Vrenjo (Relatore) dhe Z. Henri Naqellari (Anëtar).

5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 dt.28.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, vendosi me Vendimin nr.1 datë 02.08.2023 fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Gazment Shehu si dhe të caktojë Kryesues të Trupës Vlerësuese Znj. Loreta Hanxhari.

7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 03.08.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur përbërjen

e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

8. Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. *** prot. datë 07.08.2023, duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

9. Relatori i çështjes, në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:

- nenit 7, pika 1 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”,
- nenit 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 04.08.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
- nenit 7, pika 7 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 04.08.2023, pranë DPPSH-së, formularin e aftësie profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
- nenit 7, pika 4 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 04.08.2023, pranë AMP-së, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.

10. Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresë nr.*** prot., datë 21.01.2025, ka informuar Trupën e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në lidhje me Urdhërin nr. ***, datë 09.01.2025 “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, nëpërmjet të cilit Z. Gazment Qemal Shehu, me detyrë Zëvendësdrejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, transferohet dhe emërohet në detyrën Shef Sektori në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

11. Në zbatim të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit janë punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, pika 1, të këtij ligji.

12. Duke qënë se, subjekti i vlerësimit Z. **Gazment Qemal Shehu**, është transferuar nga pozicioni Zëvendësdrejtor për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë dhe emëruar në pozicionin Shef Sektori në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Trupa Vlerësuese konstaton se Z. Gazment Qemal Shehu, nuk është më subjekt vlerësimi sipas Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

13. Në këto kushte, Trupa Vlerësuese deklaron të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur procedura janë bërë ligjërisht të pamundur, duke konstatuar se ndodhet në kushtet e zbatimit të nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në Ligjin Nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit **Gazment Qemal Shehu** me funksion aktual Shef Sektori në Sektorin e Policimit në Komunitet, në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Subjektit të Vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së Vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 22.01.2025 , në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Loreta Hanxhari
Kryesues

Bora Vrenjo
Relator

Henri Naqellari
Anëtar